

# STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 560

## NGJARJET E MËVONSHME

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

### PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
<b>Hyrje</b>	
Objekti i këtij SNA-je	1
Ngjarjet e Mëvonshme	2
Hyrja në fuqi	3
<b>Objektivat</b>	4
<b>Përkufizimet</b>	5
<b>Kërkesat</b>	
Ngjarjet që Ndodhin nga Data e Pasqyrave Financiare Deri në Datën e Raportit të Audituesit	6-9
Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijeni mbas Datës së Raportit të Audituesit por Para Datës së Publikimit të Pasqyrave Financiare	10-13
Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijeni mbasi Janë Publikuar Pasqyrat Financiare	14-17
<b>Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese</b>	
Objekti i këtij SNA-je	A1
Përkufizime	A2-A5
Ngjarjet që Ndodhin nga Data e Pasqyrave Financiare deri në Datën e Raportit të Audituesit	A6-A10
Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijeni mbas Datës së Raportit të Audituesit por Para Datës së Publikimit të Pasqyrave Financiare	A11-A17
Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijeni mbasi Janë Publikuar Pasqyrat Financiare	A18-A20

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 560 “Ngjarjet e Mëvonshme” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

## Hyrje

### Objekti i këtij SNA-je

1. Ky Standard Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesit në lidhje me ngjarjet e mëvonshme në auditimin e pasqyrave financiare. Ai nuk merret me çështjet që lidhen me përgjegjësitë e audituesit për informacionet e tjera të siguruar pas datës së raportit të audituesit, të cilat janë trajtuar në SNA 720 (i rishikuar)<sup>1</sup>. Megjithatë, këto informacione të tjera mund të nxjerrin në dritë një ngjarje të mëvonshme që është brenda objektit të këtij SNA. (Ref: Para. A1)

### Ngjarjet e Mëvonshme

2. Pasqyrat financiare mund të ndikohen nga disa ngjarje që ndodhin mbas datës së pasqyrave financiare. Shumë nga kuadrot e raportimit financiar u referohen në mënyrë të veçantë këtyre ngjarjeve.<sup>2</sup> Këto kuadro të raportimit financiar zakonisht identifikojnë dy lloje ngjarjesh:
  - (a) Ato ngjarje që japin evidencë të kushteve që ekzistojnë në datën e pasqyrave financiare; dhe
  - (b) Ato ngjarje që japin evidencë të kushteve që shfaqen mbas datës së pasqyrave financiare.

SNA 700 shpjegon se data e raportit të audituesit informon lexuesin që audituesi ka marrë në konsideratë efektin e ngjarjeve dhe transaksioneve për të cilat audituesi ka marrë dijeni dhe që kanë ndodhur deri në atë datë.<sup>3</sup>

### Hyrja në Fuqi

3. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

### Objektivat

4. Objektivat e audituesit janë:
  - (a) Të marrë evidencë auditimi të përshtatshme dhe të mjaftueshme për ngjarjet, nëse kanë ndodhur të tilla, nga data e pasqyrave financiare dhe deri në datën e

<sup>1</sup> SNA 720 (i rishikuar), Përgjegjësitë e audituesit në lidhje me informacionet e tjera.

<sup>2</sup> Për shembull, Standardi Ndërkombëtar i Kontabilitetit (SNK) 10, *Ngjarjet Mbas Periudhës Raportuese* trajton ngjarjet në pasqyrat financiare, edhe të favorshme edhe të pafavorshme, të cilat ndodhin nga data e pasqyrave financiare (të cilës SNK i referohet si “mbyllja e periudhës raportuese”) dhe deri në datën kur miratohen për publikim pasqyrat financiare.

<sup>3</sup> SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një Opinioni dhe Raportimi mbi Pasqyrat Financiare*, paragrafi A66.

raportit të audituesit, të cilat kërkojnë të bëhen korrigjime, ose të jepen informacione në pasqyrat financiare, të cilat duhet të pasqyrohen në mënyrë të përshtatshme në këto pasqyra financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; dhe

- (b) Për t'ju përgjigjur përkatësisht fakteve për të cilat audituesi merr dijeni mbas datës së raportit të audituesit, për të cilat, në qoftë se audituesi ka pasur dijeni në atë datë, mund të kenë shkaktuar ndryshimin e raportit të audituesit.

## **Përkufizimet**

5. Për qëllimet e SNA-ve termat që jepen në vijim kanë këto kuptime:

- (a) Data e pasqyrave financiare – Data e mbylljes së periudhës më të fundit të mbuluar nga pasqyrat financiare.
- (b) Data e miratimit të pasqyrave financiare – Data në të cilën të gjitha pasqyrat që përbëjnë pasqyrat financiare, përfshirë shënimet përkatëse, janë të përgatitura dhe organet që kanë autoritetin përkatës pohojnë se kanë marrë përgjegjësinë për këto pasqyra financiare. (Ref: Para. A2)
- (c) Data e raportit të Audituesit – Data që audituesi daton raportin e tij mbi pasqyrat financiare në përputhje me SNA 700. (Ref: Para. A3)
- (d) Data e publikimit të Pasqyrave Financiare – Data në të cilin raporti i audituesit dhe pasqyrat financiare të audituara u bëhen disponibël palëve të treta. (Ref: Para. A4-A5)
- (e) Ngjarjet e mëvonshme – Ngjarje që ndodhin nga data e pasqyrave financiare deri në datën e raportit të audituesit, si dhe faktet për të cilat audituesi merr dijeni mbas datës së raportit të audituesit.

## **Kërkesat**

### **Ngjarjet që Ndodhin nga Data e Pasqyrave Financiare deri në Datën e Raportit të Audituesit**

- 6. Audituesi kryen procedurat e auditimit që synojnë marrjen e evidencës së nevojshme të auditimit, për t'u siguruar se janë identifikuar si duhet të gjitha ngjarjet e ndodhura nga data e pasqyrave financiare deri në datën e raportit të audituesit, të cilat kërkojnë rregullime ose dhënie të informacioneve shtesë në pasqyrat financiare. Megjithatë, nuk parashikohet që audituesi të kryejë një rishikim të vazhdueshëm të të gjitha çështjeve për të cilat procedurat e zbatuara më parë kanë dhënë konkluzione bindëse. (Ref: Para. A6)

7. Audituesi kryen procedurat që kërkohen nga paragrafi 6, në atë mënyrë që ato të mbulojnë periudhën nga data e pasqyrave financiare deri në datën e raportit të audituesit, ose sa më afër kësaj date që të jetë e mundur. Audituesi merr në konsideratë vlerësimin e rrezikut të audituesit për të përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e këtyre procedurave të auditimit, të cilat përfshijnë veprimet që vijnë: (Ref: Para. A7-A8)
- (a) Marrjen e njohurive për të gjitha procedurat që ka vendosur drejtimi për të siguruar identifikimin e ngjarjeve të mëvonshme.
  - (b) Pyetjen e drejtuesve dhe, kur është e nevojshme, e atyre që janë ngarkuar me qeverisjen, nëse kanë ndodhur apo jo ngjarje të mëvonshme të cilat mund të ndikojnë në pasqyrat financiare. (Ref: Para. A9)
  - (c) Leximin e proces-verbaleve, nëse ka të tilla, të mbledhjeve të pronarëve, të drejtimit dhe të atyre që janë ngarkuar me qeverisjen, të mbajtura pas datës së pasqyrave financiare dhe investigimet për çështjet e diskutuara në mbledhjet për të cilat proces-verbale nuk janë akoma të disponueshme. (Ref: Para. A10)
  - (d) Leximin e pasqyrave financiare të ndërmjetme më të fundit, nëse ka të tilla.
8. Në qoftë se si rezultat i procedurave të kryera, siç kërkohet në paragrafin 6 dhe 7, audituesi identifikon ngjarje që kërkojnë rregullime në, ose dhënie të informacioneve shtesë për, pasqyrat financiare, audituesi duhet të përcaktojë nëse secila prej këtyre ngjarjeve është pasqyruar apo jo në këto pasqyra financiare në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

#### *Deklarimet me Shkrim*

9. Audituesi i kërkon drejtimit dhe, kur është e nevojshme, atyre që janë ngarkuar me qeverisjen, të japin deklaratime me shkrim në përputhje me SNA 580<sup>4</sup> se të gjitha ngjarjet e ndodhura mbas datës së pasqyrave financiare dhe për të cilat kuadri i zbatueshëm i raportimit financiar kërkon rregullime ose dhënie të informacioneve shtesë janë rregulluar apo është dhënë informacioni.

#### **Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijeni mbas Datës së Raportit të Audituesit por Para Datës së Publikimit të Pasqyrave Financiare**

10. Audituesi nuk është i detyruar të kryejë ndonjë procedurë auditimi në lidhje me pasqyrat financiare mbas datës së raportit të audituesit. Megjithatë, në qoftë se, mbas datës së raportit të audituesit por para datës së publikimit të pasqyrave financiare, audituesi merr dijeni për fakte, për të cilat në qoftë se ai do të kishite dijeni në datën e raportit të audituesit, mund të kishin bërë që audituesi ta ndryshonte raportin e audituesit, audituesi duhet: (Ref: Para. A11-A12)

<sup>4</sup> SNA 580, *Deklarimet me Shkrim*.

- (a) Ta diskutojë çështjen me drejtimin dhe, kur është e nevojshme, me ata që janë ngarkuar me qeverisjen;
- (b) Të përcaktojë nëse pasqyrat financiare kanë nevojë për ndryshime dhe, nëse është kështu,
- (c) Të investigojë se si drejtimi synon të trajtojë çështjen në pasqyrat financiare.

11. Në qoftë se drejtimi ndryshon pasqyrat financiare, audituesi duhet:

- (a) Të kryejë procedura auditimi të nevojshme për rrethanat mbi ndryshimet.
- (b) Përveç rasteve kur zbatohen rrethanat sipas paragrafit 12:
  - (i) Zgjeron procedurat e auditimit të cilave u referohet paragrafi 6 dhe 7 deri në datën e raportit të ri të audituesit; dhe
  - (ii) Përgatit një raport të ri të audituesit mbi pasqyrat e ndryshuara financiare. Raporti i ri i audituesit nuk datohet përpara datës së miratimit të pasqyrave të ndryshuara financiare.

12. Kur ligji, rregulloret apo kuadri i raportimit financiar nuk ndalojnë drejtimin të kufizojë ndryshimin e pasqyrave financiare për efektet e ngjarjes apo ngjarjeve të mëvonshme të cilat shkaktojnë këto ndryshime dhe ata që janë përgjegjës për miratimin e këtyre ndryshimeve, audituesit i lejohej të kufizojë procedurat e auditimit mbi ngjarjet e mëvonshme të kërkuara sipas paragrafit 11(b)(i) për këto ndryshime. Në këto raste, audituesi, ose:

- (a) Ndryshon raportin e audituesit për të përfshirë një datë tjetër të kufizuar për këtë ndryshim ku tregohet që procedurat e audituesit mbi ngjarjet e mëvonshme janë kufizuar vetëm për ndryshimin e pasqyrave financiare të përshkuara në një shënim përkatës të pasqyrave financiare; ose (Ref: Para. A13)
- (b) Përgatit një raport të ri të ndryshuar të audituesit që përfshin një deklaram në një paragraf me Theksim të Çështjes<sup>5</sup> ose paragraf për çështje të tjera që përcjell se procedurat e audituesit mbi ngjarjet e mëvonshme janë kufizuar vetëm për ndryshimin e pasqyrave financiare siç përshkruhet në shënimin përkatës të pasqyrave financiare.

13. Në disa juridiksione, drejtimin nuk i kërkohet nga ligji, rregulloret apo kuadri i raportimit financiar të paraqesë pasqyra financiare të ndryshuara dhe, përkatësisht, audituesi nuk ka nevojë të paraqesë një raport të ri apo të ndryshuar të audituesit.

---

<sup>5</sup> Shiko SNA 706 (i rishikuar), *Paragrafët që Theksojnë Çështjen dhe Paragrafët për Çështje të Tjera në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

Megjithatë, në qoftë se drejtimi nuk ndryshon pasqyrat financiare në rrethanat kur audituesi beson se ato duhet të ndryshohen, atëhere: (Ref: Para. A14-A15)

- (a) Në qoftë se raporti i audituesit nuk është paraqitur ende tek entiteti, audituesi mund ta modifikojë opinionin siç kërkohet nga SNA 705 (i rishikuar)<sup>6</sup> dhe pastaj ta paraqesë raportin e audituesit; ose
- (b) Në qoftë se raporti i audituesit është paraqitur tek entiteti, audituesi duhet të njoftojë drejtimin dhe, përveç rastit kur të gjithë ata që janë ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në drejtimin e entitetit, ata që janë ngarkuar me qeverisjen, që të mos paraqesin pasqyrat financiare palëve të treta para se të bëhen ndryshimet e duhura. Në qoftë se pasqyrat financiare janë paraqitur pas kësaj pa ndryshimet e duhura, audituesi ndërmerr veprimet përkatëse për të kërkuar të parandalojë marrjen parasysh të raportit të audituesit. (Ref: Para. A16-A17)

### Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijeni mbasi Janë Publikuar Pasqyrat Financiare

- 14. Mbasi janë publikuar pasqyrat financiare, audituesi nuk ka detyrime për të kryer procedura auditimi në lidhje me pasqyrat financiare. Megjithatë, në qoftë se mbasi janë publikuar pasqyrat financiare, një fakt bëhet i ditur për audituesin i cili, nëse ai do të ishte bërë i ditur në datën e raportit të audituesit, do ta bënte audituesin të ndryshonte raportin e tij, audituesi duhet:
  - (a) Ta diskutojë çështjen me drejtimin dhe, kur është e nevojshme, me ata që janë ngarkuar me qeverisjen;
  - (b) Të përcaktojë nëse pasqyrat financiare kanë nevojë të ndryshohen, dhe, nëse është kështu,
  - (c) Të investigojë se si drejtimi synon të trajtojë çështjen në pasqyrat financiare. (Ref: Para. A18)
- 15. Në qoftë se drejtimi ndryshon pasqyrat financiare, audituesi duhet: (Ref: Para. A19)
  - (a) Të kryejë procedurat e nevojshme të auditimit për rrethanat e ndryshimit,
  - (b) Të rishikojë hapat e ndërmarrë nga drejtimi për të siguruar se çdokush që ka marrë pasqyrat financiare të paraqitura më parë së bashku me raportin e audituesit për to të informohet për situatën.
  - (c) Përveç rrethanave kur zbatohet paragrafi 12:

<sup>6</sup> SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinioneve në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

- (i) Zgjeron procedurat e auditimit të cilave u referohet paragrafi 6 dhe 7 deri në datën e raportit të ri të audituesit dhe nuk e daton raportin e ri të audituesit përpara datës së miratimit të pasqyrave financiare të ndryshuara; dhe
  - (ii) Paraqet një raport të ri të audituesit mbi pasqyrat financiare të ndryshuara.
- (d) Kur zbatohen rrethanat në paragrafin 12, ndryshon raportin e audituesit, ose paraqet një raport të ri të audituesit siç kërkohet nga paragrafi 12.
16. Audituesi përfshin në raportin e ri, ose të ndryshuar, të audituesit një paragraf me theksim të Çështjes ose një paragraf për Çështje Tjetër që i referohet shënimit në pasqyrat financiare i cili shpreh më gjërësisht arësyet për ndryshimin nga pasqyrat financiare të paraqitura më parë dhe nga raporti i mëparshëm i paraqitur prej audituesit.
17. Në qoftë se drejtimi nuk ndërmerr hapat e nevojshme për të siguruar që të informohet për situatën çdokush që ka marrë pasqyrat financiare të paraqitura më parë dhe nuk ndryshon pasqyrat financiare sipas rrethanave kur audituesi beson se ato kanë nevojë të ndryshohen, audituesi njofton drejtimin dhe, përveç rastit kur të gjithë ata që janë ngarkuar me qeverisjen janë të përfshirë në drejtimin e entitetit,<sup>7</sup> ata që janë ngarkuar me qeverisjen, që audituesi do të kërkojë të parandalojë marrjen parasysh në të ardhmen të raportit të audituesit. Në qoftë se, pavarësisht nga këto njoftime, drejtimi apo ata që janë ngarkuar me qeverisjen nuk ndërmarrin hapat e duhura, audituesi ndërmerr veprimet përkatëse për të kërkuar që të parandalojë marrjen parasysh të raportit të audituesit. (Ref: Para. A20)

\* \* \*

## Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese

### Objekti i këtij SNA-je (Ref: Para. 1)

- A1. Kur pasqyrat financiare të audituara u janë bashkëngjitur dokumentave të tjerë mbas publikimit të pasqyrave financiare (që janë të ndryshme nga raportet që përfshihen brenda objektit të SNA 720 (i rishikuar)), audituesi mund të ketë përgjegjësi shtesë në lidhje me ngjarjet e mëvonshme të cilat ai duhet t'i marrë parasysh, të tilla si kërkesat ligjore apo rregullatore që përfshijnë ofrimin e letrave me vlerë për publikun në juridiksionin në të cilin ofrohen letrat me vlerë. Për shembull, audituesit mund t'i kërkojë të kryejë procedura auditimi shtesë deri në datën e dokumentit të ofertës përfundimtare. Këto procedura mund të përfshijnë ato të cilave u referohen paragrafët 6 dhe 7 për t'u kryer deri në datën e ose afër datës efektive të dokumentit

<sup>7</sup> SNA 260 (i rishikuar), *Komunikimi me Personat e Ngarkuar me Qeverisjen*, paragrafi 13.

të ofertës përfundimtare dhe që lidhen me dokumentin e ofertës për të vlerësuar nëse informacionet e tjera në dokumentin e ofertës janë të njëjta me informacionet financiare për të cilat audituesi ka dijeni.<sup>8</sup>

## Përkufizimet

### *Data e Miratimit të Pasqyrave Financiare (Ref: Para. 5(b))*

- A2. Në disa juridiksione, ligji apo rregulloret përcaktojnë individët ose organet (për shembull, drejtimin ose ata që janë ngarkuar me qeverisjen) të cilët janë përgjegjës për të konkluduar se të gjitha pasqyrat që përmbajnë pasqyrat financiare, duke përfshirë edhe shënimet anekse, janë përgatitur dhe përcakton procesin e miratimit. Në juridiksione të tjera, procesi i miratimit nuk përcaktohet në ligj apo rregullore dhe entiteti ndjek procedurat e veta në përgatitjen dhe përfundimin e pasqyrave të veta financiare sipas këndvështrimit të strukturave të veta të drejtimit dhe qeverisjes. Në disa juridiksione, kërkohet miratimi përfundimtar i pasqyrave financiare nga aksionerët. Në këto juridiksione, miratimi përfundimtar nga aksionerët nuk është i domosdoshëm për audituesin për të arritur në përfundimin se është marrë evidenca e auditimit e nevojshme apo jo. Data e miratimit të pasqyrave financiare për qëllimet e SNA-ve është data më e parë në të cilën ata që kanë autoritetin e njohur vendosin se të gjitha pasqyrat që përmbajnë pasqyrat financiare, përfshirë edhe shënimet anekse përkatëse, janë përgatitur dhe se ata që kanë autoritetin e njohur kanë pohuar se kanë marrë përgjegjësinë për këto pasqyra financiare.

### *Data e Raportit të Audituesit (Ref: Para. 5(c))*

- A3. Raporti i audituesit nuk mund të datohet më përpara se data në të cilën audituesi ka marrë evidencën e nevojshme të auditimit mbi të cilën bazon opinionin mbi pasqyrat financiare, përfshirë evidencën se të gjitha pasqyrat që përmbajnë pasqyrat financiare, përfshirë shënimet anekse që lidhen me to, janë përgatitur dhe se ata që kanë autoritetin e njohur të kenë pohuar se kanë marrë përgjegjësinë për këto pasqyra financiare.<sup>9</sup> Si rrjedhim, data e raportit të audituesit nuk mund të jetë përpara datës së miratimit të pasqyrave financiare siç parashikohet në paragrafin 5(b). Mund të kalojë një periudhë kohe për arsye administrative nga data e raportit të audituesit, siç parashikohet në paragrafin 5(c), deri në datën që raporti i audituesit paraqitet tek entiteti.

### *Data e Publikimit të Pasqyrave financiare (Ref: Para. 5(d))*

- A4. Data e publikimit të pasqyrave financiare në përgjithësi varet nga mjedisi rregullator i entitetit. Në disa rrethana, data e publikimit të pasqyrave financiare mund të jetë

<sup>8</sup> Shiko SNA 200, *Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit*, paragrafi 2.

<sup>9</sup> SNA 700, paragrafi 41. Në disa raste, ligji apo rregulloret identifikojnë gjithashtu momentin në procesin e raportimit të pasqyrave financiare në të cilin pritet të përfundojë auditimi.



data që ato paraqiten tek autoriteti rregullator. Përderisa pasqyrat financiare të audituara nuk mund të publikohen pa raportin e audituesit, data që publikohen pasqyrat financiare të audituara jo vetëm që duhet të jetë në atë datë ose më vonë se sa data e raportit të audituesit, por gjithashtu të jetë në datën apo pas datës në të cilën entitetit i paraqitet raporti i audituesit.

*Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik*

- A5. Në rastin e sektorit publik, data e publikimit të pasqyrave financiare mund të jetë data në të cilën pasqyrat financiare të audituara dhe raporti i audituesit për to u paraqiten ligjvënësit apo në raste të tjera bëhen publike.

**Ngjarjet që Ndodhin nga Data e Pasqyrave Financiare deri në Datën e Raportit të Audituesit (Ref: Para. 6-9)**

- A6. Në varësi të vlerësimit të rrezikut të audituesit, procedurat e auditimit të kërkuara nga paragrafi 6 mund të përfshijnë procedura, të nevojshme për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit, që përmbajnë rishikimin apo testimin e rregjistrimeve kontabël apo transaksioneve që kanë ndodhur nga data e parasqyrave financiare deri në datën e raportit të audituesit. Procedurat e auditimit që kërkohen nga paragrafi 6 dhe 7 janë shtesë e procedurave që audituesi ka kryer për qëllimet e tjera të cilat, pavarësisht nga kjo, mund të japin evidencë rreth ngjarjeve të mëvonshme (për shembull, për të marrë evidencë auditimi për tepricat e llogarive në datën e pasqyrave financiare, të tilla si procedurat për verifikimin e ndarjes së periudhave ose procedurat në lidhje me arkëtimet e mëvonshme të llogarive të arkëtueshme).
- A7. Paragrafi 7 parashikon disa procedura auditimi në këtë kontekst, të cilat i kërkohen audituesit që t'i kryejë në përputhje edhe me paragrafin 6. Procedurat për ngjarjet e mëvonshme që kryen audituesi mund, megjithatë, të varen nga informacioni që është i disponueshëm dhe, në veçanti, nga shtrirja e tyre në regjistrimet kontabël të përgatitura nga data e pasqyrave financiare. Kur regjistrimet kontabël nuk janë të azhornuara dhe si rrjedhim nuk janë përgatitur pasqyrat financiare të ndërmjetme (qoftë për qëllime të brendshme apo për të tretë), ose nuk janë përgatitur proces-verbalet e mbledhjeve të drejtimit apo të atyre që janë ngarkuar me qeverisjen, procedurat përkatëse të auditimit duhet të marrin formën e inspektimeve në regjistrimet dhe librat e disponueshëm, përfshirë edhe në nxjerrjet e llogarive të bankës. Paragrafi A8 jep shembuj të disa çështjeve shtesë që audituesi merr parasysh gjatë kryerjes së këtyre inspektimeve.
- A8. Si shtesë të procedurave të auditimit që kërkohen nga paragrafi 7, audituesi duhet të marrë në konsideratë si të nevojshme dhe të përshtatshme për të:
- Lexuar buxhetet, parashikimet e flukseve të parave dhe raportet e tjera të drejtimit më të fundit të disponueshme për periudhat mbas datës së pasqyrave financiare;

- Pyetur, apo zgjeruar pyetjet e mëparshme me gojë apo me shkrim, të këshilltarëve ligjorë në lidhje me mosmarrëveshje dhe me pretendime.
- Marrë në konsideratë nëse mund të jenë të nevojshme deklarime me shkrim që mbulojnë ngjarje të veçanta të mëvonshme për të mbështetur evidencën tjetër të auditimit dhe si rrjedhim për të siguruar evidencë auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme.

*Pyetja (Ref: Para. 7(b))*

A9. Kur audituesi merr në pyetje drejtimin dhe, kur është e nevojshme, ata që janë ngarkuar me qeverisjen, për atë që nëse ka ndodhur ndonjë ngjarje e mëvonshme e cila ndikon në pasqyrat financiare, ai duhet të pyesë lidhur me gjendjen aktuale të zërave dhe elementëve të cilët në kohën kur janë kontabilizuar kanë qënë në formën e të dhënave paraprake apo jo përfundimtare dhe duhet të bëjë pyetje të veçanta rreth çështjeve të mëposhtme:

- Nëse kanë marrë angazhime, hua ose garanci të reja.
- Nëse ka ndodhur apo është planifikuar blerja apo shitja e aktiveve.
- Nëse ka pasur zmadhim të kapitalit apo emetim të instrumenteve të borxhit, të tilla si emetimi i aksioneve apo obligacioneve të reja, ose është bërë apo planifikuar ndonjë marrëveshje për bashkim apo për likuidim.
- Nëse ka ndonjë sekuestrim të aktiveve nga shteti ose shkatërrim të aktiveve, për shembull, nga zjarri ose nga përmbytja.
- Nëse ka pasur ndonjë zhvillim në lidhje me ngjarjet eventuale.
- Nëse janë bërë apo janë kundërshtuar rregullime kontabël të pazakonta.
- Nëse kanë ndodhur apo ka të ngjarë të ndodhin ngjarje që venë në pikëpyetje përshtatshmërinë e politikave kontabël të zbatuara në pasqyrat financiare, siç mund të jetë rasti, për shembull, në qoftë se ngjarje të tilla sjellin dyshime mbi vlefshmërinë e hipotezës së vijimësisë.
- Nëse kanë ndodhur ngjarje që janë të rëndësishme për matjen e çmuarjeve apo provizioneve të bëra në pasqyrat financiare.
- Nëse kanë ndodhur ngjarje që janë të rëndësishme për rikuperimin e aktiveve.

*Leximi i Proces-Verbaleve* (Ref: Para. 7(c))

Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik

A10. Në sektorin publik, audituesi lexon regjistrimet zyrtare të veprimtarive të rëndësishme të legjislaturës dhe pyet rreth çështjeve të trajtuara në këto veprimtari për të cilat rregjistrimet zyrtare nuk janë akoma të disponueshme.

**Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijen mbas Datës së Raportit të Audituesit Por Përpara datës së Publikimit të Pasqyrave Financiare**

*Ndikimet e informacioneve të tjera që nga audituesi njihen pas datës së raportit të audituesit* (Ref: Para.10)

A11. Megjithëse audituesi nuk ka asnjë detyrim të kryejë ndonjë procedurë auditimi në lidhje me pasqyrat financiare pas datës së raportit të audituesit, por para datës së hartimit të pasqyrave financiare, SNA 720 (i rishikuar) përmban kërkesa dhe udhëzime lidhur me informacionet e tjera të siguruara pas datës se lëshimit të raportit të audituesit, të cilat mund të përfshijnë informacionet e tjera të siguruara pas datës se raportit të audituesit, por para datës së hartimit të pasqyrave financiare.

*Përgjegjësia e Drejtimit Përpara Audituesit* (Ref: Para. 10)

A12. Siç sqarohet në SNA 210, kushtet e angazhimit të audituesit përfshijnë marrëveshjen me drejtimin për të informuar audituesin për faktet të cilat ndikojnë në pasqyrat financiare, për të cilat drejtimi ka dijeni gjatë periudhës nga data e raportit të audituesit deri në datën e publikimit të pasqyrave financiare.<sup>10</sup>

*Datimi i Dyfishtë* (Ref. Para. 12(a))

A13. Kur audituesi, në rrethanat e parashikuara në paragrafin 12(a), ndryshon raportin e audituesit për të përfshirë një datë tjetër të kufizuar me atë ndryshim, data e raportit të audituesit mbi pasqyrat financiare para ndryshimit të tyre të mëvonshëm nga drejtimi mbetet e pandryshuar sepse kjo datë informon lexuesin se kur është përfunduar puna e auditimit mbi këto pasqyra financiare. Megjithatë, në raportin e audituesit përfshihet një datë tjetër për të informuar përdoruesit se procedurat e mëvonshme të audituesit nga kjo datë janë të kufizuara me ndryshimin e mëvonshëm të pasqyrave financiare. Më poshtë jepet një ilustrim i kësaj date tjetër:

(Data e raportit të audituesit), përveç sa i përket Shënimit Y, i cili është për (Data e përfundimit të procedurave të auditimit të kufizuar me ndryshimin e paraqitur në Shënimin Y).

---

<sup>10</sup> SNA 210, *Rënia Dakord me Kushtet e Angazhimit të Auditimit*, paragrafi A24.

*Nuk Ka Ndryshim të Pasqyrave Financiare nga Drejtimi (Ref: Para. 13)*

A14. Në disa juridiksione, drejtimit nuk i kërkohet nga ligji, rregulloret apo kuadri i raportimit financiar të paraqesë pasqyra financiare të ndryshuara. Ky shpesh është rasti kur publikimi i pasqyrave financiare për periudhën pasuese është shumë i afërt, por me kushtin që të jepen informacione shtesë të përshtatshme në këto pasqyra.

*Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik*

A15. Në sektorin publik, veprimet e ndërrmarra në përputhje me paragrafin 13 kur drejtimi nuk ndryshon pasqyrat financiare duhet të përfshijnë gjithashtu raportimin veças për legjislaturën, ose për organizmat e tjera përkatëse sipas hierarkisë së raportimit, për implikimet e ngjarjes së mëvonshme në pasqyrat financiare dhe raportin e audituesit.

*Veprimi Audituesit për të Parandaluar Mbështetjen tek Raporti i Audituesit (Ref: Para. 13(b))*

A16. Audituesi duhet të përmbushë detyrime ligjore shtesë edhe kur audituesi ka njoftuar drejtimin të mos publikojë pasqyrat financiare dhe drejtimi ka rënë dakord me këtë kërkesë.

A17. Kur drejtimi i ka publikuar pasqyrat financiare pavarësisht nga njoftimi i audituesit që të mos publikojë pasqyrat financiare për palët e treta, veprimi pasues i audituesit për të parandaluar mbështetjen tek raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare varet nga të drejtat dhe detyrimet ligjore të audituesit. Si rrjedhim, audituesi duhet të marrë në konsideratë si të përshtatshme të kërkojë këshillim ligjor.

**Faktet për të Cilat Audituesi Merr Dijen Mbas Janë Publikuar Pasqyrat Financiare**

*Ndikimet e informacioneve të tjera që njihen nga audituesi pas datës së hartimit të pasqyrave financiare (Ref: Para. 14)*

A18. Detyrimi i audituesit në lidhje me informacionet e tjera të siguruara pas datës së raportit të audituesit, janë trajtuar në, SNA 720 (i rishikuar). Megjithatë audituesi nuk ka asnjë detyrim të kryejë ndonjë procedurë auditimi në lidhje me pasqyrat financiare pas datës së publikimit të pasqyrave financiare. SNA 720 (i rishikuar) përmban kërkesa dhe udhëzime lidhur me informacionet e tjera të siguruara pas datës së raportit të audituesit.

*Nuk ka Ndryshim të Pasqyrave Financiare nga Drejtimi (Ref: Para. 15)*

*Konsiderata të Veçanta për Entitetet e Sektorit Publik*

A19. Në disa juridiksione, entiteteve në sektorin publik mund t'u ndalohej nga ligji apo rregulloret publikimi i pasqyrave financiare të ndryshuara. Në këto rrethana, veprimi pasues i duhur për audituesin duhet të jetë raportimi tek organizmat përkatëse ligjore.

*Veprimi i Audituesit për të Parandaluar Mbështetjen tek Raporti i Audituesit*

(Ref: Para. 17)

- A20. Kur audituesi beson se drejtimi, ose ata që janë ngarkuar me qeverisjen, nuk ka ndërmarrë hapat e duhura për të parandaluar mbështetjen tek raporti i audituesit mbi pasqyrat financiare më parë të publikuara nga entiteti pavarësisht nga njoftimi paraprak i audituesit se ai do të ndërmarrë veprime për të parandaluar këtë mbështetje, veprimi pasues i audituesit varet nga të drejtat dhe detyrimet ligjore të audituesit. Si rrjedhim, audituesi duhet të marrë në konsideratë si të përshtatshme të kërkojë këshillim ligjor.